



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/199
Datë: 15.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, paragrafi 7. të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Ndahen mjete financiare për mbështetje të Këshillit Kombëtar Shqiptar dhe përfaqësuesve të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit në shumë prej 16,880.00 € me qëllim të përkrahjes së aktiviteteve të tyre avokuese.
- Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga buxheti i Zyrës së Kryeministrit me kod 104, nën-programi "Përkrahje për Luginën e Preshevës" me nën kod/nën program 39100, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
- Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi, transferohen në llogari bankare në emër të Këshillit Nacional Shqiptar, HALKBANK Iban: RS 35155007040000131481.
- Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë